



Shpend Solla Noé në intervistë me gazetaren Floriana Gavazzi

Gazetarja e RAI-t Floriana Gavazzi interviston shkrimtarin shqiptar

# Dhjetë vjet të historisë evropiane në romanin “Kufiri i mjegullës” të Shpend Solla Noé

Kjo vepër voluminose e juaja është një roman politik me një hapësirë të gjërë vendore e kohore – nga 1989-a deri më 1998: dhjetë vjet të historisë evropiane. Pse keni ndjerë nevojën të kaloni nga poezia e gazetaria në roman, kur këto tema historike i keni trajtuar edhe në poemat e botuara më parë? Kjo ndodhi në një mënyrë krejt natyrale, sepse ndjeva domosdoshmërinë të shprehjes në një mënyrë tjetër, për çfarë mendoja e dëshiroja t’u thosha të tjerëve. Fakti që poezia lexohet dhe shitet pak nuk qëndron. Poezia është një emocion i përjetuar, është të kapësh momentin, në masën e mënyrën e duhur. Për ngjarjet të tilla historike, si ato që përshkruaj në romanin “Kufiri i Mjegullës”, poezia në vetvetë nuk i kishte mundësitë dhe hapësirën. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gazetarinë, lindur për të përhapur e komentuar ngjarjet e përditshme. Jeta e një artikulli, edhe e një scoop-i, është e shkurtër, për aq kohë sa ai është aktual.



Lektorja Mara Da Roit duke recituar fragmente nga romanin “Kufiri i Mjegullës”

Romani, është në gjendje të tregojë një botë më të ndërlikuar, të krijojë personazhe që i përkasin grupeve shoqërore historike të caktuara, që i bën ata të jetojnë, të gëzojnë e të vuajnë si autori. Sidoqoftë, krijimtaria ime poetike vazhdon, edhe ajo në gazetari, dhe “gavata” e punës time të mëparshme në ato gjini nuk ka qenë e kotë. Mënyra ime e të shkruajturit të një proze poetike e historikisht të saktë është gjë tjetër veçse frut i eksperiencës në poezi e gazetari.

**Shumë janë qytetet e vendet në të cilat lëvizin personazhet e romanit apo përjetojnë ngjarjet: Berati, Kavaja, Kruja, Lushnja, Tirana, Bukureshti, Berlini, Athina, Parma, Kosova. Pa dyshim Berati dhe dashuria e madhe për këtë qytet rebel janë protagonistë, ashtu si edhe personazhet kryesorë të romanit tuaj. Ky qytet është edhe simbol i një mënyre të jetuiri në shoqëri, që rrezikon të humbasë me nishan e jetës së re në Itali.**

Berati ka qenë e vazhdon të jetë Ylli Polar i personazheve të mi.

Arkitektura e tij e veçantë, banorët e tij, mënyra e të të jetuarit dhe rikëmbimi shoqëror janë unike në botë. Në këtë prizëm asgjë nuk është idealizuar. Në paraqitjen e këtij qyteti ka ndikuar patjetër edhe jeta ime personale. Familja jonë u detyrua të transferohej nga Berati në Lushnje. Kjo prej meje është përjetuar gjithmonë si një lloj dëbimi nga vendi ku kishte lindur im atë dhe një pjesë e vëllëzërve e motrave të mia. Në momentet e ashpërsimit të luftës së klasës, kur më përjashtoni nga shkolla, ose kur nuk më dhanë të drejtën e studimit, unë shkoja në Berat, ku jetonin xhaxhallarët e mbi të gjithë halla ime që,

me gjithë problemet, më trajtonte ndoshta edhe më mirë se fëmijët e saj. Berati u bë për mua, në ato periudha të vështira, Karta ime e Parisit, Konvencioni im i Gjenevës, vendi ku ndihesha i mbrojtur: me pak fjalë ai ishte azili im politik. Është kjo baza e dashurisë sime të pafund për këtë qytet rebel, në të cilin askush nuk më qortonte pse nuk i qëndroja besnik normave të Partisë. Personazhi im kryesor – Ludovik Oresti – ka në DNA gjithë shpirtin tim, gjithë dashurinë time për këtë qytet magjik.

**Në roman zë vend të rëndësishëm edhe Tirana, qyteti i pushtetit**

Tirana e atyre kohrave, për banorët e provincës, ishte në përgjithësi qyteti ku të gjithë ëndëronin të jetonin. Partia i jepte shumë rëndësi kryeqytetit të saj, Tirana ishte vitrina e kombit. Ajo vizitohej edhe nga të paktët “turistë” marksistë-leninistë. Në Tiranë kishte më shumë punë. Aty punonte e jetonte elita e vendit. Ishte qyteti në të cilin kishte më shumë mundësi për të bërë karrierë, sigurisht nëse ishte besnik i diktaturës. Ndërkaq, për shumicën e shqiptarëve, ajo ishte Qyteti i Ndaluar. Kush duhej të trasferohej nga krahinat në Tiranë e vendoste Partia, pa një kontrolli të vëmendshëm të famëkëqit Sigurim të Shtetit. Nuk toleroheshin aspak kundërshtarët, që në rastet më fatlume transferoeshin në fshatra të humbur dhe, në ato më fatkeqet, të internuar në kampe o në burgje si të dënuar politikë, për periudha shumë të gjata, apo deri në vdekje. Prandaj Tirana, aq sa ishte e dashur si qendër e kulturës, artit, sportit itij, ishte po aq e urreyer me gjithë shpirt nga ata që uanin, prej ligjeve çnjëzore që vendoste, për faktin se nga ky qytet fillonin pas trimtë pas ç’d’ashpërsimit të luftës së klasave, për faktin që monumenti më i lartë i saj ishte statuja e diktatorit.

**Një qytet tjetër që zë vend të rëndësishëm në roman është Parma, ku bashkëjetojnë solidariteti, por edhe racizmi dhe**

**shfrytëzimi i punës së zezë... Ky është mendimi juaj për Italianë?**

Nuk ekziston vetëm një Itali, por disa e të ndryshme. Eksperiencia ime personale, përcjellë personazhit tim kryesor, më bëri të njoh punën e kraut në bujqësi, atë të punëtorëve në fabrikë, apo të përpunimit të proshutës... Më është dashur të kaloj muajt të tërë nëpër fjetore të varfërisë, ku nuk kishte vetëm të pastërthë, por edhe refugjatë politikë, pusher të drogës, pensionistë italianë që keqtrajtohehin nga njerëz të paskrupull duke i hedhur nëpër shkallë... Kam njohur dhe Itali të tjera, por ajo që kam mësuar nga Italia e Parë e njerëzve shpirtmirë e të thjeshtë u bë vendimtare në krijimtarinë time të mëpasshme letrare. Edhe në roman, përshpirtja e parë e familjes berataze Oresti me Parmën fisnike është e mahnitëshme. Kultura e saj, Verdi i madh, varri i Paganinit, monumentet, historia e atij qyteti i lënë ata gojëhapur. Arsyeja e dytë që i bën të ndihni mirë atje është zemërgjëria dhe solidariteti i parmensëve. Bëhet fjalë për kohën e artë të Lega Nord-it, por Orestë nuk panë kurrë racizëm të qytetarët e Parmës. Ishin njerëz që respektonin këdo që punonte me ndershmi. Kjo ishte Italia e Dytë. Këto përshpirtje filluan ndryshonin kur personazhët e mi filluan të mendonin mbijetesën e familjes. Është kjo periudhë kur Ludovik Oresti njih atë që pak më parë unë e quajta Italia e Parë – ajo e njerëzve të përlurur, ajo e emigrantëve, ajo e të të përjashtuarve nga banketi, pjesë e të cilës po ndihej edhe ai, edhe pse ishte intelektual. Tentativa e tij për t’u rikthyer punës mendore e çojnë atë të njohë një Itali të Tretë – shqetësues italian, me ligjë të mangëta për jashtëkomunitarët, të paafte t’u japë mundësitë intelektualeve të huaj t’u rikthehen profesionëve e pasioneve të tyre. Sikur të mos kish njohur dy Itali të para, Oresti



Floriana Gavazzi gjatë intervistës

mund edhe të ishte bindur që kish të bënte me racizëm shtetëror intelektual, sipas të cilit të gjithë të huajt shihen vetëm si krahe pune në ato profesione që italianëve nuk u pëlqejnë më.

**Para fillimit të romanit keni shkruar: Ç’do përjasje me njerëz apo rrethana është krejt e rastësishme. Në të vërtetë, nëpër faqet e tij gjen shumë nga jeta juaj.**

Në fakt duket kështu, megjithatë “Il confine della nebbia” nuk është një roman autobiografik. Por ç’do gjë që lexuesi gjen aty është e vërtetë dhe e jetuar – si plagët e Krishtit – sipas vlerësimit të njërit prej kritikëve të mi.

**Si është jetuar nga shqiptarët kalimi nga një diktaturë e egër në një anarcodemokraci? Shpresa? Zhgënjime?**

Shumë shpresa të fillimeve dhe shumë zhgënjime më pas. Nuk erdhi, siç shpresohet, drejtësia për të gjithë. Të parët që u zhgënjyen ishin ata që kishin humbur lirinë nëpër burgje e kampe përqëndrimi. Edhe sot ata i gjen në greva unie për kërkesa minimale të mbijetesës. Nuk janë dëmshpërlyer siç duhet familjet e të dënuarve me vdekje; të mbeturve vetëm prej persekutimit komunist nuk u është siguruar azil; nuk u është shpërlyer ndershmerisht puna e papaguar në burgje e kampe përqëndrimi; nuk janë shpërlyer ata as moralisht. Mungon njohja institucionale e tyre, mungojnë datat përkujtimore, mungojnë monumentet, mungojnë tekste që pasqyrojnë të vërtetën e tyre të hidhur, zhduken nga faqja e dheut ish-kampet e internimit – në vend që të kthehen në muzera për kohën e diktaturës – nuk janë bërë procese gjyqësore të paktën për autorët kryesorë të krimeve që pësuau. E këtu lista e gjërave të shpresuara, të premtuara por të parrealizuara bëhet shumë e gjatë. Nuk mund të lihet në harrim edhe zhgënjimi i atyre që humben pronat, pastaj intelektualët e trysur,

vënë përballë pothuajse një regjimi të ri që i mënjanon kur ata nuk aprovojnë pushtetin, korupsionin e përgjithshëm, përhapjen e shpejtë të mafies që kushtëzon edhe parimet politike... Të gjitha këto nuk ka të bëjnë aspak me idetë e një demokracie të vëtetë.

**Arratisja e pabesueshme shërben si urë për të lidhur pjesën e parë të romanit me të dytën. Pse ishte e domosdoshme ikja, kush ju ka ndihmuar, ç’farë mendoni në atë kohë?**

Ikja jonë apo e personazheve? Meqenëse “arratisjet” tona ngajnë, po përgjigjem për të dyja palët. Kur dikush ndien rrezikun për jetën, sepse ka botuar një artikull të fortë denoncues, dhe nuk e ndihmon askush që të mbrohet, e vetmja rrugëdalje mbetet ikja jashtë shtetit amë. Ishte Ambasada Italiane në Tiranë ajo që na akordoi me urgjencë tri viza gratis. Kështu u bë e mundur ikja jonë dhe e Orestëve.

**Coelum, non animum mutant qui trans mare currunt. Me ç’qëllim është përdorur ky citim? Kjo afORIZEM e Horacit, rimarrë edhe nga Seneka, shpreh më mirë gjendjen shpirtërore dhe frutin e largimit të personazheve të romanit nga atdheu i tyre. Lëndëtarët ndryshojnë qëllim – që herë pas here edhe i trys – por jo gjendjen e tyre shpirtërore, thotë Horaci. Edhe Orestëve u ndodh kjo gjë: Italia shpesh u zë frymën atyre, por sipas meje janë më të rëndësishme gjumë që lënë qytetarët e rinj në vendin ku kanë ardhur. Gjendja e tyre shpirtërore, megjithatë, mbetet për-vuajtjesë, e mëdhyshur midis realitetit dhe kujtimeve të paslyeshme të vendit të origjinës.**

**Si rilind dëshira e Ludovikut për të vazhduar pasionin e gazetarisë dhe denoncimin e mafias së re të Evropës Lindore?**

Ludovik Oresti lind si poet. Gazetar bëhet prej kërkesave të historisë. Ky është i dyti pasion i madh i tij, që sigurisht nuk e braktis në kushtet e reja të mërgimit. Vazhdimi i luftës kundër korupsionit dhe depërtimit të mafias në organet shtetërore ballkanike është pasojë illogjike e veprës së tij të mëparshme.

**Sa i përgjigjet realitetit ky pasion i Orestit?**

Plotësisht. Aq i vërtetë është ky fakt, saqë gjen përgjigje edhe në një dialog



Kopertina e romanit “Kufiri i mjegullës”, botuar në Romë, 2012

që kam patur kohët e fundit me Pietro Grasso-n (kur ai ishte akoma Prokuror Kombëtar i Antimafes Italiane – sot President i Senatit Italian). Në këtë dialog ai u shpreh se mafies shqiptare i trëmbet edhe ajo italiane!

**Në konfliktin midis Serbisë e Kosovës personazhin kryesor e shtyn etja për aventurë apo pasion?**

Nuk është një etje për aventurë. Episodet që e shohin atë si kronist në konfliktin e luftës së Kosovës duhen kuptuar si thirrje e gjakut të popullit nga ai vjen, të shqiptarëve.

**Si ta kuptojmë titullin “Kufiri i mjegullës”?**

Mjegulla në titull? Është pasiguria, pamundësia për të programuar të ardhmen.

**Çfarë ka në program tani Shpend Solla Noé?**

Jam duke punuar me përsosjen e ciklit të romaneve rreth rënies së komunizmit dhe të dukurive historike që e pasuan. Vazhdoj të

kultivoj njëkohësisht edhe pasionet e mia të hershme.

**Çfarë përfaqëson për ju të shkruajturit në italisht?**

Një sfidë të përditshme. Kur shkruaj në gjuhën tuaj, përpiqem të mëndoj njëzetekatër orë rreth në italisht. Lexoj shumë, jo vetëm romane e poezi, por ç’do gjë që më bie në dorë, duke mos nënvlehtësuar as edhe etiketat e faturat nëpër dyqane. Flas shumë me qytetarët vendas, sidomos me të rinjtë – krijues e shpërndarës të shumë neologjizmeve. Mbjaj me vete gjithmonë një bllok të vogël ku shkruaj, edhe fshehurazi, fjalën apo shprehjen e re që sapo kam dëgjuar. Në bazë të gjithçkaje, sidoqoftë, mbetet studimi i gjatë dhe i lodhshëm i gramatikës, pastaj i... pastaj i... Për t’i rënë shkurt: është një betejë e përhershme.

**Përkthema nga italishtja: Edi Salla**